



Dendrometri mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

1) Vlerësimi i lartësisë

Vendoset dendrometri në një distancë të çfarëdoshme nga syri duke tendosur kordonin dhe vizohet druri. Intervali i instrumentit nga syri si edhe distanca nga druri ndryshohen gradualisht deri sa pikat "k" dhe "h" të mbulojnë përkatësisht majën dhe bazën e drurit. Raporti i intervalit "hi" në instrument ndaj intervalit të përgjithshëm "hk" është 1 : 10. Si rjedhim edhe lartësia e projeksonit të pikës "i" mbi dru nga baza e tij shpreh 1/10 e lartësisë së drurit. Për gjetjen e lartësisë së drurit mjafton të matet lartësia e projeksonit të kesaj pike mbi dru dhe të shumëzohet me 10.

2) Përcaktimi i sipërfaqes bazimetrike (Parini Bitterlich)

Po të vizohet nën një kënd të caktuar horizontal, prej një vëndqëndrimi në pyll, $d_{1,30}$ i të gjithë drurëve duke bërë një rotullim të plotë rreth vetes, sipërfaqja bazimetrike e grumbullit është funksjon i hapjes së këndit dhe i numurit të drurëve të numruar të cilët duken më të trashë se sa hapja e këndit.

Po të mbahet dendrometri horizontalisht në një distancë 50 cm nga syri "r" (50 cm gjatësi e kordonit = distanca "r" nga bebja e syrit deri tek pllakëza), gjërësia "fg" formon me syrin një kënd, për të cilin çdo dru i numruar (pra që ka gjërësi aparente më të madhe) shpreh një sipërfaqe bazimetrike prej $1m^2$ për ha. Po të vizohet drurët me gjërësinë "op" ose "mn", përdoren faktorët 2 ose 4. Në këtë rast sipërfaqja bazimetrike e matur do të shumëzohet me faktorët përkatës (2 ose 4) për të marrë sipërfaqen bazimetrike për hektar.

Për matjet e kryera në sipërfaqe të pjerrëta duhet që sipërfaqja bazimetrike për ha e matur të shumëzohet me faktorin korrigjues k ($k = 1 : \cos \alpha$) i cili merret nga tabela që gjendet mbi dendrometrin në funksjon të këndit të pjerrësisë më të madhe (α) të terrenit.

Gjatësia e kordonit mund të ndryshojë nën ndikimin e faktorëve të jashtëm si p.sh. lagështia efi. Prandaj duhet që nga koha në kohë të verifikohet gjatësia e kordonit dhe duke e çvendosur të korrigjohet me anë të vidës rregulluese.

E rëndësishme është: Çdo përdorues i aparatit duhet që para përdorimit të përgjithshëm të testojë veten, domethënë të pavojë me anë të matjeve në se duhen numruar ose jo drurët kuçi. Raposti midis $d_{1,3}$ (m): Distanca (m) nga vëndqëndrimi tek aksi i drurit, duhet të jetë: $> 1:50$ tek gjërësia e numurimit 1, $> 1:35$ tek gjërësia e numurimit 2, dhe $> 1:25$ tek gjërësia e numurimit 4.

3. Vlerësimi i pjesëve të volumnit për drurin e veçuar.

Veprohet si tek vlerësimi i lartësisë. Me tre ndarjet "b, c, d" druri i përfshirë midis "a" dhe "e" ndahet në katër seksione me volum të barabartë.

4. Vlerësimi i volumnit të grumbullit pyjor me tarifën e lartësisë së formës (të. LAER SPEIDEL 1959).

Mbas vlerësimit të lartësisë me zatare të grumbullit (hm), nga tabela mbi dendrometrin, mund të merret lartësia e formës për katër llojet kryesore të drurëve.

- Ei = Dushk (Quercus robur, Quercus petraea)
- Bu = Ah (Fagus sylvatica)
- Fi = Hormog (Picea abies)
- Ki = Pishë (Pinus sylvestris)

Me sipërfaqen bazimetrike të matur mund të llogaritet me anë të formulës $V = G \cdot FH$ volumni i grumbullit pyjor për ha në m^3 me lëvore.